

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Reuters: Kosova pret një vendim që mund të tronditë raportet me Perë ndimin
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/14/gjyqi-ndaj-ish-krereve-te-uck-se-reuters-kosova-pret-nje-vendim-qe-mund-te-trondite-raportet-me-perendimin/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:38:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 18:33:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	749c9154400b617d0bbc73b8742be569bf45159b8b87a5e42ebfb5701c205c7e
TEKSTI	27aee125fa8ecdf10a16c2b232bc8689ab58668a715d3c754114dd831606e699
PAMJA	c0068900d91e9f04440db06f687b65f607e3f68c89de23709ac8432f625eab57

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	63e3624e90950de362243c135ef974f5508a9a24de101ff9cdb8f58c16933175
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/63e3624e90950de362243c135ef974f5508a9a24de101ff9cdb8f58c16933175>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Reuters: Kosova pret një vendim që mund të tronditë raportet me Perëndimin

Aktualitet

Publikuar: 14/09/2026



Thaçi ishte president i Kosovës nga viti 2016 deri në vitin 2020 dhe kryeministër nga viti 2008 deri në vitin 2014.

“Vendimi është një ngjarje tektonike”, tha Agon Maliqi, bashkëpunëtor i lartë jorezident në Qendrën për Europën të institutit Atlantic Council.

Sipas tij, nëse Thaçi shpallet i pafajshëm dhe lirohet, kjo mund të ndryshojë ekuilibrin e forcave në politikën e Kosovës në favor të partisë së tij opozitare me orientim pro-perëndimor dhe të rikthejë besimin te një bashkëpunim më i madh me Perëndimin për sigurinë rajonale.

Maliqi tha se politika e Kosovës është thellësisht e ndarë, veçanërisht për marrëdhëniet me Perëndimin. Nëse Thaçi shpallet fajtor, Kosova mund të largohet edhe më shumë nga Perëndimi sesa ka ndodhur tashmë nën kryeministrin Albin Kurti, shtoi ai.

“Rezultati i vendimit do të ketë gjithashtu ndikim të menjëhershëm mbi marrëdhëniet etnike tashmë të tensionuara brenda Kosovës, pasi emocionet do të jenë të forta dhe forcat radikale, përfshirë aktorë të jashtëm, mund të kenë interes për të nxitur tensione”, tha Maliqi.

Në një perspektivë më afatgjatë, vendimi mund të ndikojë gjithashtu te mundësitë për një paqe të qëndrueshme me Serbinë, në varësi të reagimit të Beogradit, shtoi ai.

Me të lexuarat

Bosi i Lurrës
hap kartel kompanish dhe fondacionesh. A po pastron në ndërtim



Rahmëfzohen
Pashtrimit...



Alarm të rremë
për bomba në shkollë, arrestohet

Mandi i atagan!
Krejt i shpërdalë...
mashtrohet me formularin e dekriminalizimit dhe pasurinë, afera me depot



Lufta e padukshme e
Kremlinit: nga kokat e derrave te ndërhyrjet



Nëse jo dhe
Schroeder
pastron paratë e aferave të AKSHI-it me kulla në Kosovë, Gerond Meçe i kaloi qin...



Edhe nëse Thaçi shpallet i pafajshëm për akuzat për krime lufte, ka pak gjasa që ai të lirohet menjëherë, pasi prokurorët kanë kërkuar një dënim prej gjashtë vitesh burg ndaj tij në një çështje të veçantë për ndërhyrje të dyshuar te dëshmitarët. Thaçi i mohon edhe këto akuza.

Një tribunal për krime lufte do të shpallë të mërkurën aktgjykimin në procesin ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, për akuza që lidhen me konfliktin e viteve '90 për pavarësinë nga Serbia.

Prokurorët kanë kërkuar dënime me nga 45 vjet burg për Thaçin, 58 vjeç, dhe tre ish-komandantë të tjerë të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ata i mohojnë të gjitha akuzat, ndërsa avokatët e tyre kanë kërkuar shpalljen e pafajësisë.

Në qytete të ndryshme të Kosovës janë vendosur ekrane të mëdha ku shfaqet numërimi mbrapsht deri në shpalljen e vendimit, që pritet të nisë në orën 10:00 në Hagë, ose 08:00 GMT. Të shtunën, mijëra njerëz morën pjesë në një tubim në kryeqytetin Prishtinë, duke kërkuar lirin e tyre.

Procesi gjyqësor ka nxjerrë në pah se sa të gjalla mbeten kujtimet e luftërave ballkanike të viteve '90 për njerëzit e rajonit dhe sa të rrënjosura vazhdojnë të jenë qëndrimet për çështjet etnike që dolën në pah gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë.

Funerali i madh publik i zhvilluar javën e kaluar në Beograd për gjeneralin serb të Bosnjës, Ratko Mladiç, i cili vdiq ndërsa vuante dënimin me burgim të përjetshëm për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, tregoi se opinionin publik vazhdon të jetë i ndarë për luftërat e Ballkanit të viteve '90.

Sipas analistëve politikë, rezultati i procesit ndaj Thaçit mund të ndikojë në marrëdhëniet e Kosovës me Perëndimin, veçanërisht me aleatin e saj, Shtetet e Bashkuara, si dhe të krijojë tensione të reja me Serbinë, e cila nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur.

Thaçi dhe tre ish-komandantët e tjerë akuzohen për përndjekje, vrasje, torturë dhe zhdukje të detyruar të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës gjatë dhe menjëherë pas kryengritjes së viteve 1998-1999, e cila përfundimisht çoi në shpëputjen nga Serbia të Kosovës me shumicë shqiptare.

Prokurorët kanë deklaruar se më shumë se 100 kundërshtarë politikë dhe persona të perceptuar si bashkëpunëtorë të forcave serbe të sigurisë u vranë gjatë asaj që ata e përshkruajnë si një përpjekje të dhunshme të UÇK-së për të marrë kontrollin politik.

Avokatët e Thaçit kanë argumentuar se akuzat janë të pabazuara dhe përbëjnë një përpjekje për të rishkruar historinë. Sipas tyre, nuk ekziston asnjë provë që e lidh drejtpërdrejt Thaçin me ndonjë prej krimeve të pretenduara apo që tregon se ai kontrollonte komandantët e tjerë të UÇK-së.

Ngjarje tektonike

Dhomat e Specializuara të Kosovës, të përbëra nga gjyqtarë dhe juristë ndërkombëtarë, janë thellësisht të papëlqyera në Kosovë. Nën presion ndërkombëtar, Prishtina pranoi në vitin 2015 krijimin e gjykatës, e cila trajton sipas ligjit të Kosovës çështje për krime lufte ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së.

Për shkak të rrezikut të frikësimit të dëshmitarëve, shumë prej dëshmitarëve të prokurorisë kanë dëshmuar me dyer të mbyllura, gjë që ka shtuar mosbesimin e kosovarëve ndaj këtij institucioni.

“Për ne, Hashim Thaçi është hero i Kosovës, luftëtar i lirisë. Ai duhet të kthehet në Kosovë”, tha Mentor Plakaj, banor i Prishtinës.

Thaçi ishte president i Kosovës nga viti 2016 deri në vitin 2020 dhe kryeministër nga viti 2008 deri në vitin 2014.

“Vendimi është një ngjarje tektonike”, tha Agon Maliqi, bashkëpunëtor i lartë jorezident në Qendrën për Europën të institutit Atlantic Council.

Sipas tij, nëse Thaçi shpallet i pafajshëm dhe lirohet, kjo mund të ndryshojë ekuilibrin e forcave në politikën e Kosovës në favor të partisë së tij opozitare me orientim pro-perëndimor dhe të rikthejë besimin te një bashkëpunim më i madh me Perëndimin për sigurinë rajonale.

Maliqi tha se politika e Kosovës është thellësisht e ndarë, veçanërisht për marrëdhëniet me Perëndimin. Nëse Thaçi shpallet fajtor, Kosova mund të largohet edhe më shumë nga Perëndimi sesa ka ndodhur tashmë nën kryeministrin Albin Kurti, shtoi ai.

“Rezultati i vendimit do të ketë gjithashtu ndikim të menjëhershëm mbi marrëdhëniet etnike tashmë të tensionuara brenda Kosovës, pasi emocionet do të jenë të forta dhe forcat radikale, përfshirë aktorë të jashtëm, mund të kenë interes për të nxitur tensione”, tha Maliqi.

Në një perspektivë më afatgjatë, vendimi mund të ndikojë gjithashtu te mundësitë për një paqe të qëndrueshme me Serbinë, në varësi të reagimit të Beogradit, shtoi ai.

Edhe nëse Thaçi shpallet i pafajshëm për akuzat për krime lufte, ka pak gjasa që ai të lirohet menjëherë, pasi prokurorët kanë kërkuar një dënim prej gjashtë vitesh burg ndaj tij në një çështje të veçantë për ndërhyrje të dyshuar te dëshmitarët. Thaçi i mohon edhe këto akuza.

Pagat, lufta vazhdon pas 17 shtatorit/ Rexhaj: Një përpjekje e sofistikuar e magjistratëve për të marrë pushtet

Alarmi i rremë për bombë në një shkollë në Tiranë, Koçiu: Çmenduri e mirëfilltë kriminale. Hapësira publike nuk është fushë eksperimentesh

CIA planifikoi vrasjen e Bin Laden para 11 shtatorit, por pastaj u tërhoq

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)